



REPUBLIKA E KOSOVË / REPUBLIC OF KOSOVO AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. _____ Dep. <u>DPK</u>	Nr. Prot. _____ Br. Prot. <u>03-02/3611/16</u> Prot No. _____
Nr. l faq. _____ Broj stranica <u>02</u>	Data _____ Datum <u>10-10-2016</u> Date _____
PRISHTINE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 (paragrafi 1.1), nenin 5 (paragrafi 1.5) dhe nenin 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 24 (paragrafi 11 dhe 12) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 10.10.2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK – 03-02-2974/16, për znj. Filloreta Rexha – Këshilltare Komunale në Komunën e Dardanës (Kamenicës), për shkak se ajo ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, nr. AKK – 03-02-2974/16, për znj. Filloreta Rexha – Këshilltare Komunale në Komunën e Dardanës (Kamenicës), dhe njëkohësisht person i autorizuar në biznesin individual “JURIDIKA-F”, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Fillimisht znj. Rexha është njoftuar me shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit për fillimin e procedurës së shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit.

Pas pranimit të kësaj shkrese zyrtarja e lartë është kontaktuar nga zyrtarët e AKK-së dhe është njoftuar me faktet që posedon Agjencia në lidhje me këtë situatë si dhe për ndryshimet që duhet të bëj, për të shmangur konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit publik.

znj. Rexha ka kuptuar situatën e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit të saj publik dhe për të shmangur këtë situatë, vullnetarisht ka vendosur ta shuaj biznesin.

Ndërkohë ka dërguar në Agjenci informatat zyrtare, të lëshuara nga Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë, me të cilat vërtetohet se ka mbyllur biznesin individual "JRIDIKA-F". Me këtë zyrtarja e lartë ka shmangur situatën e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

Andaj u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.

II. Në pajtim me nenin 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së;
- Z./znj. (zyrtarit përgjegjës).

Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit


Hasan Preteni

